

Tre (3) Vendimet të mbledhjes së X-të (Dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 23 Nëntor 2020;

1. Vendimin për Ndryshim Plotësimin e Vendimit të KK 01Nr. 104/01-1879/18 të datës 28.02.2018 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) / Lënda: 01Nr. 104/02-29023/20;
2. Vendimin për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021/ Lënda: 01Nr. 060/01-28891/20; dhe
3. Vendimin për transfer të mjeteve nga kategoria e pagave dhe shtesave sipas buxhetit të vitit 2020 / Lënda: 01Nr. 104/02-28960/20.

Tre (3) Vendime të tjera të mbledhjes së 10 të KK janë dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë nga Zyra Ligjore e autoritetin mbikëqyrës MAPL.



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kacanik

Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-29023/20

Kaçanik, 23.11.2020

Në mbështetje të nenit 17 dhe 58 pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. të nenit 6 pika b dhe h të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, që Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 23 Nëntor 2020, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN PLOTËSIM E VENDIMIT TË KUVENDIT KOMUNAL 01-Nr.104/01-1879/18 TË DATËS 28.02.2018 PËR FORMIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)

1. Me këtë Vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit Komunal 01-Nr.104/01-1879/18 të datës 28.02.2018, për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB).
2. Ndryshim Plotësimet e Vendimit të Kuvendit të Komunës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet tek pika 2 paragrafi 2.14 dhe pika 4 e vendimit, ashtu që:

2.1 Anëtari **Kjani Sallahu** - i përcaktuar si në pikën 2.14 - Përfaqësuesi i OJQ-ve, Mediat lokale, Komuniteti i biznesit dhe Komuniteti i personave me aftësi të kufizuar, hiqet nga KKSBB dhe në vend të tij caktohet, **Remzi Reka**-përfaqësues nga OJQ, koordinator i Organizatës për Mbrojtjen e Mjedisit "Gjethi".

2.2 Me këto ndryshime, ndryshohet lista e përcaktuar si në nenin 4 e cila iu ka bashkangjitur vendimit.

3. Pikat tjera të Vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës;
2. KKSBB;
3. Kijani Sallahu dhe Remzi Reka;
4. Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
5. Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr.104/01-1879/18
Kaçanik, 28.02.2018

Në mbështetje të nenit 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28 Shkurt 2018, mori këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi(KKSB)

1. Me këtë Vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Kaçanikut.
2. Përbërja e KKSB është :
 1. Kryetari i Komunës - Kryesues,
 2. Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik,
 3. Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik,
 4. Përfaqësuesi nga komunitetet etnik pakicë në komunë,
 5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
 6. Zyrtari për Barazi Gjinore,
 7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim,
 8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit,
 9. Përfaqësuesi i FSK-së,
 10. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike,
 11. Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi,
 12. Përfaqësuesi nga Sektori Emergjencave Civile Komunale,
 13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
 14. Përfaqësuesi i OJQ-ve lokale,
 15. Përfaqësuesi i mediave lokale,
 16. Përfaqësuesi i bizneseve lokale,
 17. Përfaqësuesi nga komuniteti lokal i personave me aftësi të kufizuar.
3. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është përgjegjës për veprimet dhe detyrat e përcaktuara sipas Udhëzimit Administrative Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
4. Emrat e përfaqësuesve të KKSB janë si në Listën e hartuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, e cila i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës - MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e KKSB-së.

Me këtë Vendim, njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Anëtarët e KKSB-së njoftohen përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Zyra e Kryetarit

01-Nr.104/01-1879/18

Kaçanik, 20.02.2018

Përfaqësuesit e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi:

1. Kryetari i Komunës –Kryesues-Besim Ilazi
2. Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik-Afrim Haliti
3. Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame në Kaçanik –Menduh Rexha
4. Përfaqësuesi nga komunitetet etnike pakicë në Komunë-
5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete-
6. Zyrtari për Barazi Gjinore-Vedat Dema
7. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit-Zahir Doda
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Jashar Selimi
- 9.Përfaqësuesi i FSK-së- Ali Vishi
10. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kosovare Murseli
- 11.Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal Për Siguri në Bashkësi-Fatmir Çaka
- 12.Përfaqësuesi nga Sektori Emergjencave Civile Komunale-Ramadush Osmani
13. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-Fadil Guri
14. Përfaqësuesi i OJQ-ve lokale, mediave, bizneseve, personave me aftësi të kufizuar, Kijani Sallahu.



FORUMI I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE TË KAÇANIKUT

PËR: Kryetarin e Komunës së Kaçaniut, z. Besim Ilazi

NGA: Forumi i OJQ-ve të Kaçanikut



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Data	16.11.2020	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
01		10462-28930 -1	

NDRYSHIME NË PËRFAQËSIMIN E KKSB-së

I nderuar kryetar, Besim Ilazi!

Nëpërmjet kësaj shkrese kërkoj nga ju që të nisni procedurat për ndryshimin-plotësimin e përfaqësimit në Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi nga OJQ-të, mediet, PAK-të dhe zejtarët.

Nga KKSB pozitën e lëshon vullnetarisht përfaqësuesi i deritanishëm, Kjani Sallahu, ndërkaq në vend të tij nga tani e tutje KKSB-në e përfaqëson z. Remzi S. Reka, koordinator i Organizatës për Mbrojtjen e Mjedisit "Gjethi".

Ju lutem që procedurat e ndryshim-plotësimit të përfaqësimit të fillojnë menjëher, në mënyrë që përfaqësimi me këtë ndryshim të fillojë që nga takimi i radhës i KKSB-së.

Kaçanik
16.11.2020



Kryetari i FOJK-ut
Kjani Sallahu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kacanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 060/01-28891/20
Kaçanik, 23.11.2020

Në bazë të nenit 40.2(d) të Ligjit Nr. 03L-/040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28 /04 Qershor 2008 e Republikës së Kosovës), të neneve 34.5 dhe 36 lidhur me nenet 40, 41 dhe 42 të Statutit të Komunës, të nenit 15(c) lidhur me nenin 24 të Rregullores për Punë të Kuvendit, të Propozim Planit të hartuar nga Komisioni i Kuvendit 01Nr. 060/01-28891/20 prej datës 13.11.2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 23 Nëntor 2020. Mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2021.
2. Plani vjetor i cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban; numrin e mbledhjeve, pikat – temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit, vendi dhe ora e mbajtjes, kryesimi i mbledhjeve si dhe numrin e mbledhjeve që do të kompensohen për aktivitetin e kuvendit dhe trupave punuese të tij, për vitin 2021.
3. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në vitin 2021, planifikon t'i mbajë gjithsej, 12 Mbledhje të Rregullta. Çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës i paraprinë Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.
4. Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës, do të mbahen sipas këtij Plani të Punës:

**PLANI I Mbledhjeve të Kuvendit
Për vitin 2021**

Nr.	Mbledhjet	Periudha Kohore	Vendi i mbajtjes	Ora	Rendi i Punës	Kryesimi i mbledhjeve
1	2	3	4	5	6	7
01.	Mbledhja e I	Javën e fundit të muajit janar	Katin i III Salla e KK	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e fundit e Rregullt e Kuvendit të Komunës e vitit 2020; 2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021; 3. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021; 4. Plani i Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Afësi të Kufizuara, për aktivitetin e zhvilluar në vitin 2021; 5. Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021; 6. Plani i Punës së KKSB për vitin 2021; 7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor, 2020/2021; 8. Informatë për zbatimin e planit të integritetit; 9. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.	Kryesuesi i KK
02.	Mbledhja e II	Javën e fundit të muajit shkurt	- " -	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2020, në vitin 2021; 3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020; 4. Informatë e Zyrës së Personelit për aktivitetin e zhvilluar në vitin 2020; 5. Raportit (Informatë) Final Financiar i Komunës për vitin 2020; 6. Raporti i Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020.	-

03.	Mbledhja e III	Javën e fundit të muajit mars	-“-	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e II-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2020; 3. Raport i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020; 4. Raporti i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020; 5. Raport i Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për aktivitetin e zhvilluar në vitin 2020; 6. Raporti (Informatë) i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2020; 7. Informatë mbi zbatimin e Ligjit kundër duhanit në territorin e Komunës së Kaçanikut 8. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës.	-“-
04.	Mbledhja e IV	Javën e fundit të muajit prill	-“-	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti Tremujor Financiar i Komunës, Janar – Mars 2021; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës. 4. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.	-“-

05.	Mbledhja e V	Javën e fundit të muajit maj	-“-	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IV-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Informatë mbi Qarkoren e I (Parë) Buxhetore të Ministrisë së Financave; 3. Informatë për aktivitetin e komiteteve funksionale të kuvendit; 4. Informatë për zbatimin e Rregullores për mbrojtjen e drejtave të fëmijëve. 5. Shqyrtimi i ndonjë, Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës.	-“-
06.	Mbledhja e VI	Javën e fundit të muajit qershor	-“-	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e V-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KAB) për vitet 2022-2024; 3. Propozim Vendimi për Rishikimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2021; 4. Shqyrtimi i Raportit (Informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së; 5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 6. Informatë për realizimin e Planit të Prokurimit. 7. Informatë për performancën e Komunës për vitin 2020.	-“-

07.	Mbledhja e VII	Javën e dytë të muajit korrik	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VI-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti Gjashtëmuor Financiar, Janar - Qershor 2021; 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2020; 4. Plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas Raportit të Auditorit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2020; 5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 6. Informatë e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2020/2021, 7. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.	--
08.	Mbledhja e VIII	Javë e fundit e muajit korrik			1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VII-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Informatë për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2021; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 4. Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrije-shirjeve; 5. Informatë për aktivitetin e Zyrës për Barazi Gjinore.	
09.	Mbledhja e IX	Javën e fundit të muajit shtator	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VIII e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2022; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2021; 4. Raporti i zbatimit të Rekomandimeve të Raportit të Auditorit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2020;	--

					5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Vendi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; dhe 6. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor, 2021-2022.
10.	Mbledhja e X	Javën e fundit të muajit tetor	“_”	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IX e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës, Janar- Shtator 2020; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 4. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.
11.	Mbledhja e XI	Javën e fundit të muajit nëntor	“_”	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e X e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 3. Informatë e DUKMM për procesin e legalizimit të objekteve të ndërtimit; 4. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi gjendjen e përgjithshme të komunës; 5. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë për të mbjellat vjeshtore;
12.	Mbledhja e XII	Periudha: 19 - 24 Dhjetor 2021	“_”	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XI e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Vendi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 3. Informatë e KKSBB për aktivitetin e zhvilluar; 4. Informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2021. 5. Informatë për funksionimin e këshillave lokale; dhe 6. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.
Në vitin 2021 parashihet të jetë vit i Zgjedhjet lokale, kështu që mbledhjet e fundit (XI dhe XII) mund të mos mbahen					

5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës caktohen nga Kryesuesi i Kuvendit, në konsultim me Kryetarin e Komunës.

5.1 Minimumi i mbledhjeve të Rregullta të Kuvendit të Komunës për një vit kalendarik është 10 Mbledhje të Rregullta, prej tyre se paku 5 Mbledhje të Rregullta duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik, sipas LVL neni 43.2.

5.2 Maksimumi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës me karakter pune, me pagesë për një vit kalendarik është 12 Mbledhje.

6. Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjatë vitit 2021, i ka paraparë me Planin e Punës me i mbajtur gjithsej 12 Mbledhje me pagesë.

6.1 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera më shumë se 12 Mbledhje të rregullta, por nga mbledhja e 13 të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës me karakter pune, e rregullt apo jo e rregullt, do të jenë pa pagesë.

6.2 Aktiviteti i zhvilluar i Kuvendit të Komunës është barrë e Buxhetit të Komunës, për vitin 2021 nga Programi buxhetor, Zyra e Kuvendin e Komunës, për; Për Paga dhe Mëditje dhe për: Mallra dhe Shërbime;

6.3. Shpenzimet: Për Paga dhe Mëditje do të paguhën:

6.3.1 Paga mujore e Kryesuesit të Kuvendit për 12 muaj,

6.3.2 Paushall mujor për anëtarët e KK sipas akteve në fuqi,

6.3.3 Kompensimi i mëditjeve për 12 Mbledhje të Kuvendit për 26 anëtarë të Kuvendit, për pjesëmarrje në mbledhje,

6.3.4 Kompensimi i mëditjeve për 12 Mbledhje të KPF për 6 anëtarë, për pjesëmarrje në mbledhje,

6.3.5 Kompensimi i mëditjeve për 10 Mbledhje të Komitetit për Komunitete për 7 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje,

6.3.6 Kompensimi i mëditjeve për 6 Mbledhje të Komitetit për Shërbime Publike për 5 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje.

6.3.7 Kompensimi i mëditjeve për 6 mbledhje të Komitetit Konsultative për Persona me Aftësi të Kufizuara, për 7 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje.

6.3.8 Nëse mungon anëtari në mbledhje të Kuvendit apo të Komiteteve, heqja e mëditjes do të bëhet në pajtim me aktet në fuqi.

6.4. Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime janë të përcaktuara me Buxhetin e Komunës të vitit 2021, ku përfshihen;

6.4.1 Shpenzime të furnizimit për zyre dhe blerje tjera mallra e shërbime;

6.4.2 Shpenzime për dreka zyrtare, ku përfshihen: Shpenzimet e bufesë për Zyrën e Kryesuesit, Shpenzimet për Ujë dhe Pije për Mbledhje të Kuvendit dhe Komitete të Kuvendit, Shpenzimet për Debatin Publik të organizuar me qytetarë të komunës, për buxhetin e komunës për vitin 2022 dhe Projektionet për vitin 2023-2024 (ujë dhe pije), organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit,

6.4.3 Shpenzime të tjera; udhëtime zyrtare jashtë vendit, informimit publik, marketing, botime e publikime dhe shpenzime të përfaqësimit.

7. Të gjitha mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen vetëm ditëve të punës.

7.1 Materialet që i adresohen Kuvendit të Komunës, janë kryesisht çështje të propozuara nga ekzekutivi i komunës, e që kalojnë procedurën e shqyrtimit dhe

aprovimit të KPF-s, dhe të njëjtat, me Rekomandim të KPF-s i kalojnë Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim apo në procedurë të mëtejme.

7.2 Njoftimet për mbledhje të Kuvendit të Komunës bëhen publike.

7.3 Materialet për Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit të Komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

7.4 Njoftimet dhe Materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

8. Ky Plan Pune i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, është Plan orientues edhe për mbledhjet e KPF-s, të cilat mbledhje do të mbahen se paku 3 ditë para mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, me të gjitha pikat e propozuara, me përjashtim të Procesverbalit të mbledhjeve të Kuvendit, Planeve dhe Raporteve të trupave punuese të KK.

9. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në muajin shtator do të mbajë Dëgjim Publik me qytetarë, për Propozim-Buxhetin e komunës për vitin 2022 dhe Projektionet për vitet: 2023-2024, para se të aprovohet buxheti në kuvend.

10. Të gjitha mbledhjet e Rregullta të KK do të jenë hapura për; qytetarë, media dhe për çdo të interesuar tjetër.

10.1 Nëse ndonjë mbledhje e Rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura, atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës.

10.2 Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarë të komunës, mediat dhe të interesuar të tjerë, në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

11. Kuvendi i Komunës për gjatë muajit gusht, do të jetë në Pushim Vjetor.

11.1 Për fillimin dhe mbarimin e pushimit, Kuvendi i Komunës do të njoftohet paraprakisht.

11.2 Për gjatë pushimit (muajin gusht) nuk planifikohet mbajtja e ndonjë mbledhje përveç nëse paraqitet ndonjë çështje eventuale, atëherë nuk përjashtohet mundësia të mblidhet Kuvendi i Komunës.

12. Plani i përcaktuar i Kuvendit të Komunës për vitin 2021, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime varësisht nga kërkesat dhe nevojat që paraqitën.

13. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
01Nr. 104/02-28969/20
Kaçanik, 23. 11.2020

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008) të Ligjit Nr.03/L-048 - Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008) të Ligjit nr.03/L-221- Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.07/L-001) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. Nr. 1/19 Mars 2020) të nenit 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 23 Nëntor 2020, mori këtë:

V E N D I M
PËR TRANSFER TE MJETEVE NGA KATEGORIA E PAGAVE DHE SHITESAVE
SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2020

1. Me këtë Vendim, Lejohet Transferi i mjeteve nga kategoria e Pagave dhe Shtesave, sipas buxhetit të vitit 2020, fondi burimorë 10, nga Nën-programet:

1.1 Administrata 16328, shuma prej	20,000.00 €
1.2 Buxheti 17528, shuma prej	19,000.00 €
1.3 Pylltaria dhe Inspeksioni 47108, shuma prej	4,500.00 €
1.4 Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 66445, shuma prej.....	6,500.00 €
1.5 Shërbime Kulturore 85028, shuma prej	2,000.00 €
1.6 Infrastruktura rrugore 18028, shuma prej	3,000.00 €
1.7 Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik 48028, shuma prej	10,000.00 €

2. Mjetet nga Nën programet e përcaktuara si në pikën paragrafët e pikës 1. të këtij Vendimi, Transferohen në kategorinë e Pagave dhe Shtesave në Nën programin:

2.1 Shërbimet e Shëndetësisë Primare 74700, shuma prej 65,000.00 €.

3. Me shumën e mjeteve të transferuara së në pikën 2 paragrafi 2.1, do të mbulohen obligimet ndaj stafit mjekësor për shpërblyerjet jubilarë bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të arritur mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës Nr.05-3815 e datës 12.06.2018.

4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Formularët standard nga MF të plotësuar me shumën e lëvizura sipas Nën-Programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.

5. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante); dhe
3. Arkivi.

